



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë
Data: 16.10.24 Nr.: 1435

Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh. A. në Mitrovicë, Zyra e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në dispozitat e nenit 50 par.1 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me Konkursin e Brendshëm për plotësimin e vendit të punës për pozitën Shef i rrjetit të kanalizimit, pas konstatimit të një gabimi teknik tek pjesa e përshkrimit mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve dhe kalendari i përafërt i përshkruar në konkurs, me qëllim të përmirësimit të këtij gabimit teknik dhe zhvillimit të rregullt të procedurës së rekrutimit, me datën 16.10.2024, lëshon këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatet, të cilët kane aplikuar por edhe ata të cilët do të aplikojnë në pozitën Shef i rrjetit të kanalizimit se është lëshuar një gabim tek pjesa e përshkrimit të konkursit mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve dhe kalendari i përafërt.

Zhvillimi i procesit të konkursit do të bëhet sipas kriterëve të caktuara me Udhëzimin Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe Rregulloren e Brendshme të kompanisë për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik nr.647/2.

Përmirësimi i gabimit teknik e i cili do të te jetë pjesë e procedurës rekrutuese është si vijon:

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Testimi me shkrim – deri ne shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista – deri ne njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) - deri ne dhjet (10) pikë

Kalendari i përafërt: brenda 25 dite testi me shkrim, brenda 25 dite intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë UA01/2024.

Arsyetim

Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, ka shpallur procedurën e rekrutimit për pozitën Shef i rrjetit të kanalizimit, konkursi është publikuar me datë 08.10.2024 dhe do të jetë i hapur deri me datë 22.10.2024.

Në kuadër të konkursit të publikuar ne ueb faqe e kompanisë, është lëshuar një gabim teknik , gjegjësisht në pjesën e përshkrimit të mënyra e vlerësimit si dhe kalendari i përafërt ku në vend se përshkruhet forma e rregullt:

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Testimi me shkrim – deri ne shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista – deri ne njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) - deri ne dhjet (10) pikë

Kalendari i përfaqësues: brenda 25 dite testi me shkrim, brenda 25 dite intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë UA01/2024.

Është shënuar:

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Intervista – deri ne njëzet (70) pikë
Jetë përshkrimi (CV) - deri ne dhjet (30) pikë

Kalendari i përfaqësues: intervistat me gojë brenda 25 ditëve dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë UA01/2024.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të këtij gabimi teknik, konform dispozitës së nenit 50 par.1 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative, bëhet përmirësimi i konkursit të brendshëm për pozitën Shef i rrjetit të kanalizimit.

Ky përmirësim, bëhet me qëllim të zhvillimit të rregullt të procedurës së rekrutimit duke pasur synim që të evitohet çfarëdo lloj mundësie për keqinformim të kandidatëve potencial .

Faleminderit për mirëkuptim,

Me respekt,

Zyra e Burimeve Njerëzore

